

Elbasan, me 14.10.2002

AVOKAT
RESHIT TRUNGU
TIRANE - ALBANIA

A K T I I T H E M E L I M I T

I SHOQERISE TREGTARE - G E A M +- SH P K

E L B A S A N

Ne Elbasan, sot me daten 10. 10. 2002, perpara meje avokat RESHIT TRUNGU, me qender veprimtarie ne Tirane, u paraqit :

- Z. GEZIM MURATAJ, i biri i Myqeremit dhe i Veres, i date- lindjes 20.12.1958, lindur e banues ne Elbasan, me zotesi te plote per te vepruar, me arsim te larte, i cili kerkoi redaktimin e ketij akti themelimi te shoqerise se krijuar prej tij, me permbajtjen qe vijon :

Art. 1-: K r i j i m i

Shoqeria krijohet nga z.GEZIM MURATAJ, si pronar i vetem i saj ne baze te legjislacionit shqiptar e ne veçanti ne baze te ligjeve Nr 7512 date 10.8.1991, Nr 7638 date 19.11.1992, Nr 7667 date 28.1.1993 dhe ne veprimtarine e saj do te zbatoje gjithë legjislacionin qe lidhet me cdo sferë te objektit te saj.

Ne baze te ligjit shqiptar z.GEZIM MURATAJ eshte Ortaku i Vetem i shoqerise.

Art. 2-: P e r c a k t i m i

Shoqeria e krijuar eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (shpk), per nga madhesia e kapitalit, objekti i veprimtarise dhe forma e organizimit.

Ajo eshte shoqeri private shqiptare dhe ne baze te ligjit ajo vleresohet e quhet shoqeri tregtare.

Shoqeria e krijuar eshte person juridik.

Ajo do te zbatoje e do te veproje ne baze te kerkesave te ketij Akti Themelimi si dhe te Statutit te shoqerise, qe perbejne dokumentacionin baze te saj.



Art. 3 -: E m e r t i m i

Shoqeria e krijuar do te emertohet :

SHOQERIA " G E A M " , sh p k .

Emeri i shkurtuar i saj eshte * GEAM *, shpk.

Art. 4 -: S e l i a

Qendra e veprimtarise se Shoqerise * G E A M * shpk eshte qyteti i Elbasanit dhe adresa legale e saj eshte :

"Lagjja*Fetah Ekmekçiu* , rruga * Unaze * , Nr 7.-"

Art. 5 -: Koha e veprimtarise

Shoqeria " G E A M " , shpk - Elbasan do te ushtroje veprimtari ne fushat qe perbejne objektin e punes se saj per nje kohe mbi 10 vjet.

Ushtrimi i veprimtarise se panderprere pas kalimit te afatit 10 vjecar nuk kerkon vendim te ri te organeve te shpk.

Art. 6 -: O b j e k t i

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete :

Eksporti, importi dhe tregtia me shumice e pakice e artikujve industriale, ushqimore, fruta perime, lende e materiale ndertimi,elektrike,ekeltroshtepiake, hidrosanitare,lekure,galanteri kosmetike e detergjente,lende e materiale kinkalerie e kancelarie, leter, mobileri e pajisje, shfrytezim,pastrim e sistemim pyjor, veprimtari ne fushen e ushqimit social, restorante,bar bufe,kafene, sherbime hotelerie balneare nellixha e ne vende turistike,sherbime te transportit te udhetareve dhe te mallrave.

Zgjerimi i objektit te shpk eshte kompetence eskluzive e ortakut te vetem.

Art. 7-: Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke.

Kapitali themeltar perfaqson kuoten e vetme te themeluesit e pronarit te shpk, Ortakut te Vetem z.GEZIM MURATAJ.

Madhesia e kapitalit themeltar, raportet e tij ne para e ne natyre, zmadhimi e zvogelimi i kapitalit,kushtet e transferimit do te realizohen sipas percaktimeve te bera ne Statutin e shpk.

Art. 7 -: Organizimi e drejtimi

Shoqeria do te organizohet e drejtohet sipas percaktimeve qe ben Ortaku i Vetem dhe eshte kompetence e tij.

Organet drejtuese jane Ortaku i Vetem dhe Administratori.

Ortak i Vetem dhe Administrator i shoqerise * G E A M* shpk Elbasan eshte GEZIM MURATAJ.

Kompetencat e organeve percaktohen ne statutin e shpk.

Art. 8 -: Mbarimi i shoqerise

Shoqeria mbaron dhe personi juridik e pushon veprimtari-ne e tij ne kushtet ligjore te percaktuara si dhe kur :


1.- Me vendim te Ortakut te Vetem kerkohet mbyllja e shpk dhe qregjistrimi i personit juridik.

2.- Shoqeria thithet nga nje shoqeri tjeter.

3.- Shoqeria ndodhet ne kushtet e falimentimit sipas Ligjit Nr 8901 date 23.5.2002.

Art. 9 -: Miratimi

Ortaku i vetem pasi njihet nen per nen me Aktin e Themelimit dhe eshte dakort me permbajtjen e tij e nenshkruan ne pranine time avokatit si hartues i tij.



REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTEREVE

NR 1601 REP. 385 KOL.

ORTAKU I VETEM :
GEZIM MURATAJ

V E R T E T I M

Sot me daten 11.10.2002, tetor dymije e dy, ne zyren e noterise dhe para meje noterit u paraqit shtetasi Gezim Murataj i biri i Myqeremit, i datelindjes 1958, banues ne Elbasan, qe kerkoi vertetimin e Aktit te Themelimit te Shoqerise "GEAM", shpk Elbasan dhe pasi e nenshkruan vertetohet dhe prej meje noterit.

NOTER



NOTERE
ENKELEJDA MARINAJ

Tirane, me 11.10.2002

AVOKAT
RESHIT TRUNGU
TIRANE - ALBANIA

S T A T U T I

I SHOQERISE TREGTARE * G E A M *-SH P K

E L B A S A N

Shoqeria e krijuar do te ushtrroje veprimtari private ne fushat qe perbejne objektin e punes se saj ne baze te legjislacionit shqiptar n e teresi e ne vecanti te ligjeve Nr 7512, date 10.08.1991, Nr 7632 date 4.11.1992, Nr 7638 date 19.11.1992, Nr 7667 date 28.1.1993, si dhe te legjislacionit qe ka te beje me fushat konkrete te veprimtarise se saj, si dhe do te organizohet dhe do te veproje duke respektuar edhe kerkesat e ketij s t a t u t i :

KAPITULLI I

KRIJIMI, EMERTIMI, PERCAKTIMI, SELIA E OBJEKTI

Neni 1 : Krijimi i shoqerise

Shoqeria krijohet nga z. GEZIM MURATAJ, ne baze te Aktit te Themelimit Nr 220, date 10.10.2002, sipas kerkesave te legjislacionit shqiptar, si shoqeri private shqiptare.

Themeluesi i shoqerise qe eshte dhe pronar i saj ne baze te legjislacionit shqiptar quhet ORTAKU I VETEM.

Per efekt evidencimi, saktesojme se ortak i vetem i shoqerise eshte z. GEZIM MURATAJ.

Akti i Themelimit dhe Statuti i shoqerise perbejne dokumentacionin baze te krijimit te saj.

Neni 2 : P e r c a k t i m i

Shoqeria e krijuar ruan edhe ne kete Statut gjithë karakteristikat e percaktuara ne Aktin e Themelimit, se :



2.1 - Lloji i shoqerise

Shoqeria e krijuar eshte SHOQERI ME PERGJEGJESI TE PUNEFIZUAR (SHPK), per nga madhesia e kapitalit, objekti i punesi dhe forma e organizimit.

2.2 -: E m e r t i m i

Shoqeria e krijuar emertohet :
SHOQERIA " G E A M ", shpk.

2.3 -: Qendra e veprimtarise

Qendra e veprimtarise se Shoqerise " G E A M ", shpk eshte qyteti i Elbasanit dhe adresa legale e saj eshte :
"Lagjja * Fetah Ekmekciu *, rruga * Unaze *, Nr 7 - Elbasan."

2.4 -: Koha e veprimtarise

Shoqeria " G E A M ", shpk - Elbasan do te ushtroje veprimtari te panderprere ne fushat qe perbejne objektin e punes se saj per nje kohe mbi 10 vjet.

Ushtrimi i veprimtarise se panderprere pas kalimit te afatit 10 vjecar nuk kerkon vendim te ri te organeve te shpk.


Neni 3 -: O b j e k t i

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete :

Eksporti, importi dhe tregtia me shumice e pakice e artikujve industriale, ushqimore, fruta perime, lende e materiale ndertimi, elektrike, elektroshtepiake, hidrosanitare, galanteri e lekure, kozmetike e detergjente, materiale kancelerie, makineri dhe pajisje, linja prodhimi e sherbimi, vshfrytezim, pastrim e sistemim pyjor, veprimtari ne fushen e ushqimit social restorante, bar bufe e kafene, sherbim balnear e hotelerie ne llixha e vende turistike, sherbime te transportit te mallrave e te udhetareve.

Per cdo fushe te objektit te saj shoqeria eshte e detyruar te respektoje kerkesat ligjore qe lidhen me to, si dhe te marre lejet perkatese nga organet kompetente kur kerkohet nga ligja para fillimit te veprimtarise perkatese.

Zgjerimi i objektit te shoqerise eshte kompetence eskluzive e Ortakut te vetem.



Neni 7 : V u l a

Shoqeria ka vulen e vet te identifikimit e cila ka fuqi ligjore kur vendoset perbri nenshkrimt te Ortakut te Vetem, e te administratorit te shoqerise.

Vula vendoset per probleme qe kane te bejne vetem me shoqerine dhe veprimtarine e saj.

Neni 8 : Marredheniet me persona juridike a fizike

Shoqeria eshte e lire dhe gezon te drejten qe te hyje ne marredhenie me persona juridike a fizike, shteterore a private, vendase ose te huaja, per te gjitha veprimtarine, per pjese te saj, ose per pjesmarrje me kapital te perbashket.

pasqyrimi i ketyre mardheneve behet duke respektuar kerkesat e legjislacionit shqiptar per keto ceshtje.

Per lidhje e marredhenie te shoqerise me persona juridike a fizike te huaj nuk kerkohet autorizim paraprak nga organe te caktuara shteterore.

Neni 9 : Personaliteti juridik e zotesia per te vepruar

Shoqeria e fiton personalitetin e saj juridik, si person juridik shqiptar, pavaresisht nga personat fizike qe e krijojne, vetem pas regjistrimit ne Gjykatën e rrethit te Tiranes.


Ajo e fiton zotesine per te vepruar ne fushat qe perbejne objektin e punes se saj pas regjistrimit ne Degen e Tatimeve e Taksave te rrethit ku eshte dhe selia e personit juridik.

Neni 10 : Marredheniet e punesimit

Shoqeria eshte e lire dhe ka te drejte te punesoje punonjes, punetore e specialiste te fuahave te ndryshme, per te realizuar objektin e punes se saj.

Marredheniet e punesimit rregullohen duke u mbeshtet ne legjislacionin shqiptar te punes (Kodi i Punes).

Ne themel te ketyre marredheneve eshte kontrata e



punes qe lidhet midis saj si punedhenese dhe te punesuarit si
marrjes.

Punedhenesi merr persiper detyrimin per pagesen vec
pages edhe te sigurimeve shoqerore, si dhe marrjen e masave per
mbrojtjen ne pune, sigurimin teknik, te higjienes se punes, etj.

KAPITULLI II

MARRREDHENIET EKONOMIKE E FINANCIARE

Neni 11 : Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i Shoqerise " G E A M ", shpk
Elbasan eshte 100.000 leke i perbere nga 100 pjese nga 1000 leke.

Ai perfaqson kuoten e vetme e te pandare te pronarit
e themeluesit te saj, Ortakut te Vetem z. GEZIM MURATAJ.

Madhesia e kuotes se kapitalit themeltar e shprehur
ne kete nen perfaqson vetem vleren e saj ne para.

Derdhja e kuotes se kapitalit themeltar dhe konferma
bankare e realizimit te ketij operacioni i bashkengjitet statutit.

Neni 12 : Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transfe-
rueshme vetem ne klauzolat e percaktuara ne kete nen :

a) - Pjeset e kapitalit themeltar si dhe pasuria e
shpk jane prone e vetme e Ortakut te Vetem dhe jane lirisht te trans-
ferueshme ne rruge trashegimie midis paraardhesve e pasardhesve,
sipas dispozitave te Kodit Civil.


b) - Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar
ndermjet bashkeshorteve ose ndarjeje pasurore midis tyre behet
vetem kur ka disponim me shkrim te noterizuar nga Ortaku i Vetem.

c) - Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar ne
persona te trete, juridike a fizike, behet me vendim te Ortakut te
Vetem, si kompetence e toj e gjithnje me akt noterial, perndryshe
eshte e pavlefsheme.

Ne kete rast zbazohen dispozitat perkatese te Kodit
Civil qe kane te bejne me kontraten e shitjes.

Veprimet qe kerkohet te behen me akt noterial dhe
nuk jane bere te tilla jane te pavlefshem.

Pasuria e shoqerise evidencohet me vehte dhe shenohet
ne librat perkates te shoqerise.





Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar per te respektuar klauzolat e percaktuara ne kete nen i behen te ditura dhe cdo rast organeve perkatese.

Neni 13 : Zmadhimi i kapitalit

Zmadhimi i kapitalit eshte ne kompetencen eskluzive te ortakut te vetem dhe operacionet e zmadhimit te kapitalit vihen ne veprim vetem pas miratimit me shkrim te vendimit te marre prej tij dhe te vistos se dhene per kryerjen e tyre.

Vendimi me shkrim per zmadhimin e kapitalit, si dhe shenimet perkatese per realizimin e tij i bashkengjiten statutit, vec shenimeve qe jane bere ne librin perkates te shoqerise dhe qe evidencon veprimtarine e ortakut te vetem si i tille.

Neni 14 : Zvogelimi i kapitalit

Zvogelimi i kapitalit eshte ne kompetencen e ortakut te vetem dhe realizohet prej tij vetem pas vendimit me shkrim dhe te lejimin qe i ben kryerjes se operacioneve perkatese financiare.

Zvogelimi i kapitalit duhet te realizohet vetem pas nje analize te hollsishme te faktoreve e shkaqeve qe e determinojne zvogelimin e kapitalit dhe duhet medoemos qe te motivohet nga humbjet.

Raporti i zvogelimit te kapitalit hartohet nga administratori i shoqerise, ose per te, kur gjykohet e nevojshme mund qe te ngarkohet nje ekspert kontabel i autorizuar.

Kur ka kreditore, te cilet kane dhene kredi para marrjes se vendimit per zvogelimin e kapitalit, keta duhet te njoftohen per vendimin e marre dhe motivet qe e kane detyruar shoqerine per marrjen e tij.

Kur zvogelimi i kapitalit nuk motivohet, ose kur per te nuk jane dakort kreditorët qe kane dhene kredi para marrjes se tij, kreditorët kane te drejte t'i drejtohen gjykates brenda nje muaji nga data e publikimit ose e marrjes se vendimit nga ortaku i vetem per zvogelimin e kapitalit.

Kundershtimi i vendimit nga ana e kreditoreve ne gjykate i pezullon operacionet e zvogelimit te kapitalit deri ne vendimin e gjykates.

Neni 15 : E drejta per informim
e miratimi i llogarive

Ortakut i Vetem gezon te drejten e informimit per te gjithë problemet qe kane te bejne me shoqerine dhe punen e saj dhe qe eshte njekohesisht detyrim per gjithë te tjeret qe punojne ne shoqeri per ta informuar rregullisht.

Krahas informimit verbal e drejta per informim e tij realizohet edhe nepermjet dokumenteve qe pergatiten dhe qe i paraqiten atij per t'i analizuar e per te vendosur per to.

Vec dokumenteve te veprimtarise se perditeshme ortakut te vetem i paraqiten ne menyre te detyruar e qe dhe ai eshte i detyruar t'i analizoje: e miratoje : raporti i administrimit, inventaret e llogarite vjetore.

Keto dokumente paraqiten nga administratori se bashku me tesktet e vendimeve qe do te miratohen.

Neni 16 : F i t i m i

Percaktimi i fitimi eshte kompetence e ortakut te vetem qe e realizon kete pas analizes qe i ben materialeve te pergatitura e qe i paraqiten nga administratori.

Fitimi perbehet nga diferenca midis te ardhurave te realizuara dhe shpenzimeve te bera brenda te njejtës periudhe per realizimin e tyre gjate vitit financiar te cilit :

- a) - i jane zbritur shumat per rezerven e domosdoshme
- b) - i jane zbritur ose shtuar humbjet ose fitimet e bartura nga vitet e mepareshme.

Te punesuarit nuk marrin pjese ne percaktimin e fitimit dhe nuk perfitojne prej tij. Ata as nuk informohen per fitimet qe ka realizuar shoqeria e menyren e perdorimit te tij.


Te punesuarit per punen qe bejne marrin pagen perkatese sipas kontrates individuale te punes.

Neni 17 : Rezerva e domosdoshme

Shoqeria nga fitimi i realizuar gjate vitit financiar krijon rezerven e domosdoshme si kerkese e detyruar ligjore.

Rezerva e domosdoshme perfaqson nje shume ne vlere te pakten sa 1/20 e fitimit.

Rezerva e domosdoshme eshte e detyrueshme derisa ajo te



arrije 1/10 e kapitalit themeltar.

Neni 18 : Viti ushtrimor
Bilanci

Viti ushtrimor dhe bilanci i shoqerise mbyllen me 31 dhjetor te cdo vitit.

Bilanci ushtrimor dhe llogarite humbje fitime perpilohen nga organi administrativ sipas kerkesave te ligjit " Per kontabilitetin ".

Shqyrtimi i veprimtarise se shoqerise bazohet ne aktet e dokumentimit te veprimtarise se saj e qe eshte detyrim ligjor per personat e ngarkuar, te cilet mbajne e pergjegjesi per keze.

Neni 19 : Marrja e kredive

Shoqeria eshte e lire te marre kredi e hua nga persona juridike a fizike, shteterore a private, vendas ose te huaj per te perballuar i zhvilluar veprimtarine e saj.

Shumat e kredive, kushtet e marrjes, te perdorimit e te kthimit te tyre, pergjegjesite per detyrimet, etj jane ne kompetence te ortakut te vetem.

Shoqeria ka te drejte te jape kredi nga mjetet e saj financiare e materiale me miretim te ortakut te vetem.

KAPITULLI III

ORGANIZIMI, DREJTIMI, ADMINISTRIMI


Neni 20 : O r g a n i z i m i

Organizimi i shoqerise eshte ne kompetencen e ortakut te vetem qe e realizon kete ne funksion te arritjes se objektit te punes e te ideve te tij per rritjen e fitimeve te shpk.

Ai vendos per krijimin e njesive, reparteve, te tregtimin e te prodhimit, te degeve e sektoreve, sipas ligjeve ne fuqi.

Organizimi i shpk ndryshohet sa here e gjykon te nevojshme ortakut i vetem.

Veprimet e organizimit te shoqerise pasqyrohen ne dokumentacionin e ortakut te vetem.



Neni 21 : D r e j t i m i
Organet drejtuese

Shoqeria gjate veprimtarise se saj ne realizimin e objektit te punes udhehiqet nga organet drejtuese.

Organet drejtuese te shoqerise jane :

- a) - Ortaku i Vetem, si organ vendimor
- b) - Administratori, si organ ekzekutiv

Caktimi i organeve drejtuese eshte ne kompetencen e ortakut te vetem qe e ben kete qe me themelimin e shoqerise qe ne aktin perkates cakton dhe personat ne keto detyra.

Pergendrimi i organeve te shpk ne nje dore te vetme, e ortakut dhe e administratorit, nuk e perjashton, por kerkon qe te respektohen kerkesat e sejcilit organ duke i shprehur sipas natyres qe i kryen e te organit qe i perkasin.


Administratori i shpk mund te jete mund te jete dhe nga persona fizike jashte saj e qe s'jane ortake.

Neni 22 : ORTAKU I VETEM

Ortaku i vetem si organ vendimor i shpk ka ne kompetencen ekskluzive te tij trajtimin e cdo problemi qe ka te beje me shoqerine.

Per efekt te evidencimit e te percaktimit te kompetencave qe trajtohen vetem si ortak i vetem, qe nuk mund t'i trajtoje askush tjeter e qe nuk mund te nenshkruhen prej tij vetem ne emerit "ortaku i vetem", jane :

- Miratimi i statutit e ndryshimi i tij
- Organizimi dhe ndryshimi i organeve te shpk
- Emerimi e shkarkimi i administratorit, kur nuk e kryen vete kete detyre
- Blerja, kembimi e shitja e pasurise se palujteshme dhe e te drejtave reale mbi to.
- Marrja e kredive dhe dhenia e tyre
- Marrja pjese ose heqja dore nga shoqeri te tjera
- Analiza e miratimi i raportit te administrimit, te inventarit dhe llogarive vjetore
- Pranimi e pushimi nga puna i punonjesve si dhe



caktimin e pagave e te shperblimeve te tjera te punonjesve.

- Pushimi i veprimtarise se personit juridik dhe marrja e masave per operacionet e likujdimit, caktimin e likujdatoreve, kohen e veprimtarise dhe kompetencat e tyre.

Per keto probleme nenshkruhet vetem me emertimin :
" Ortaku i Vetem ".

Neni 23 : A d m i n i s t r a t o r i

Shoqeria ne varesi te percaktimit qe ben ortaku i vetem drejtohet ne veprimtarine e perditeshme nga nje ose disa administratore.

Administratori caktohet nga ortaku i vetem qe ne Aktin e Themelimit te shoqerise. Ai mund te ndryshohet me pas me akte te tjete te tij si ortak i vetem.

Administratori ka ne kompetence te tij kryerjen e te gjitha detyrave qe i gjykon se jane ne interes te shpk me perjashtim te atyre qe jane te ortakut te vetem te percaktuara ne nenin 22 te statutit, ose perjashtimeve te tjera te bera me pas me shkrim nga ortaku i vetem.

Per shkelje te bera gjate veprimtarise se tij administratori mban pergjegjesi ligjore ndaj te treteve per demet qe i shkakton atyre ne veprimtarine drejtuese por dhe ndaj shoqerise kur nuk eshte ortak ne te.

KAPITULLI IV


MBARIMI I SHOQERISE (SHPK)

Neni 24 : Pushimi i veprimtarise

Shoqeria e mbaron veprimtarine dhe personi juridik pushon se qeni ne keto kushte:

- a) - Me vendim te Ortakut te Vetem
- b) - Kur shoqeria thithet nga nje shoqeri tjeter ne kushtet ligjore te percaktuara
- c) - Shoqeria rezulton me humbje qe e cojne ate ne falimentim.

Ne cdo rast, shkaqet qe determinojne e percaktojne pushimin e veprimtarise se shpk e mbarimin e personit juridik, si gjedhje e vecante, duhet te analizohet nga ortaku i vetem.



Neni 25 : L i k u j d i m i

Ne rastet kur personi juridikpushon veprimtarine e tij pas analizes se bere kesaj gjendjeje ,te shkaqeve qe cuan ne kete situate , ortaku i vetem merr vendimet perkatese per veprimet e likujdimit te shpk e te marredhenieve te saj me te tretet.

Kur shoqeria ndodhet ne kushtet e falimentimit zbatohen kerkesat e Ligjit Nr 8901 date 23.5.2002 " Per falimentimin".

Neni 26 : R e f e r i m i

Persa nuk parashikohet ne kete statut, problemet do te trajtohen e zgjidhen duke iu referuar ligjeve perkates ne castin e nevojës per to.

Ligji referues eshte vetem ligji shqiptar, pavaresisht se marredheniet mund te jene e problemet mund te lindin me persona juridike a fizike te huaj.

Ajo qe do t'i trajtoje eshte vetem gjykata shqiptare.

Neni 27 : M i r a t i m i

Ortaku i vetem z. GEZIM MURATAJ, pasi njihet me permbajtjen e statutit nen per nen dhe eshte dakort me te, e miraton duke e nenshkruar ne pranine time avokatit si hartues i saj.

AVOKAT I K O K O T I
RESHIT TRUNGU
TIRANE - ALBANI
[Signature]

ORTAKU I VETEM
GEZIM MURATAJ

[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE

NR 1601 REP. 383 KOL.

V E R T E T I M

Sot me date 11.10.2002 (tetor dymije e dy) ne zyren e noteri se dhe para meje noterit, u paraqit personalisht z.Gezim Murataj, i biri i Myqeremit, i datelindjes 1958, banues ne Elbasan, i cili kerkoi vertetimin noterial te Statutit te Shoqerise "G E A M ",shpk Elbasan, qe pasi e nenshkruan vertetohet dhe nga une noteri.

N O T E R

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHE PARLAMENTI
DHE KURIA E PLEQES
DHE KURIA E JEMINJES
NOTER
ELBASAN

NOTERE
ENKELEJDA MARINAJ
[Signature]